

**TEMA PER TITULLIN MASTER I SHKENCES
INTEGRIME EVROPIANE DHE ADMINISTRATE PUBLIKE
NGA
DJELLZA HASANI**



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI FILOZOFIK
Departamenti i Shkencës Politike
Integrime Evropiane dhe Administratë Publike**

Prishtinë, Prill 2023

EKSPOZE E TEMËS

Efektet e populizmit në gjeopolitikën e zgjerimit të Bashkimit Evropian drejtë Ballkanit Perëndimor pas traktatit të Lisbonës

Mentor: Prof. Asoc. Dr. Bardhok Bashota

Kandidat-ja: Djellza Hasani

Ky hulumtim synon ta trajtojë efektet dhe ndikimin që ka pasur populizmi në rritjen e euroskepticizmit dhe në orientimin e politikës së zgjerimit të Bashkimit Evropian, duke ofruar një pasqyrë pak më të detajuar të trendit të populizmit në vendet anëtare të BE-së, kauzave dhe strategjive të populistëve, ndikimeve që populistët kanë pasur në politikat e BE-së dhe trendit të populizmit në rajonin e Ballkanit Perëndimor, rajon ky i cili pavarësisht rritjes së euroskepticizmit në vetë vendet anëtare të BE-së, mbetet me pikësynime të qarta për integrim në të. Rritja e partive populiste ka qenë një fenomen mjaft i pranishëm, sidomos në dekadën e fundit në Evropë. Krizat e njëpasnjëshme gjatë kësaj dekade kanë shërbyer që partitë populiste t'i ndërtojnë kauzat dhe strategjitë e tyre bazuar mbi këto kriza dhe efektet që kanë prodhuar ato. Kriza financiare e vitit 2008 dhe kriza e emigracionit në vitin 2015 mbetën dy prej periudhave më të favorshme të cilat u shfrytëzuan maksimalisht nga populistët e të dyja taborreve ideologjike, por që dominuan partitë populiste të së djathtës. Duke etiketuar faktorë dhe aktorë të ndryshëm si shkaktarë të këtyre krizave dhe duke premtuar politika për tejkalimin e tyre, populistët mobilizuan elektorat dhe arritën të vinin në pushtet. Kritika e drejtuar drejt BE-së për shkak të masave shtrënguese pas krizës financiare dhe kritika për mosmenaxhimin e duhur të emigracionit nxiti rritjen mosbesimit ndaj institucioneve të saj, duke shënuar një vale euroskepticizmi, e cila kulmoi me daljen e Britanisë nga BE. Edhe pse partitë populiste arritën të ndikonin në debatet publike dhe të faktorizoheshin në masë të konsiderueshme, në nivel të BE-së dhe në orientim të politikave të saj kanë pasur ndikim pothuajse minimal.

STRUKTURA E PUNIMIT

Punimi është i ndarë në katër kapituj, ku secili kapitull ka disa nënkapituj në të cilët synohet të trajtohen çështjet dhe pyetjet e ngritura për këtë hulumtim.

Kapitulli I

Konsiderata teorike mbi populizmin dhe llojet e tij

Në këtë kapitull ofrohet një kornizë teorike mbi bazën e të cilës trajtohet populizmi si fenomen, strategji politike, diskurs publik dhe përcaktim ideologjik. Paraqiten disa këndvështrime autorësh të ndryshëm për atë se çka është populizmi dhe si definohet ai. Ka një kategorizim të llojeve të populizmit dhe mënyrave se si manifestohet ai, e cila ndihmon në të kuptuarit më të qartë të karakteristikave që kanë partitë populiste. Dhe, në këtë kapitull përfshihet edhe një rezymë e shkurtër për momentumin e populizmit në Bashkimin Evropian, arsyet dhe suksesin që disa prej partive kanë pasur.

Kapitulli II

Trendi, kauzat dhe strategjitë populiste në vendet anëtare të BE-së

Në këtë kapitull shpjegohet trendi i rritjes së populizmit në vendet anëtare të BE-së. Peisazhi politik në vendet anëtare të Bashkimit Evropian tregon se në shumë prej tyre, partitë politike populiste kanë arritur të fitojnë terren dhe të faktorizohen në një masë të konsiderueshme. Ky faktorizim i partive populiste ka ndikuar edhe në orientimin e diskutimeve në drejtime të caktuara për disa prej çështjeve që kanë qenë zhvillimet kyçe të një dekade. Pikërisht dekada e fundit është periudha kohore kur brenda vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, partitë populiste kanë marrë përqindje të larta elektorale dhe madje në disa vende edhe kanë marrë pushtetin. Arsyet që diskutohen si nxitëse të rritjes së partive populiste janë nga më të ndryshmet, por

padryshim kriza financiare e vitit 2008, kriza e borxhit sovran, si dhe kriza e emigracionit mbeten shtylla mbi bazën e të cilave u ndërtuan mesazhet populiste.

Syriza në Greqi, Fronti Kombëtar në Francë, Liga Veriore dhe Lëvizja Pesë Yjet në Itali, Fidesz në Hungari janë vetëm disa prej partive populiste që kanë dominuar dekadën e fundit në Evropë. Gjithashtu, trajtohen kauzat që liderët populist evropian ndërtuan, të cilat janë të lidhura pashmangshëm me krizat nëpër të cilat kaluan vendet e tyre dhe kontinenti evropian në përgjithësi. Një pikë tjetër e përfshirë në kapitullin e dytë janë edhe strategjitë e populistëve. Kështu, Strategjitë politike të të gjitha partive populiste të sipërpërmendura janë pothuajse të ngjashme për mënyrën si i kanë ndërtuar kauzat, pikënisjen e rritjes së tyre elektorale, diskursin e përdorur, çështjet mbi të cilat e kanë vendosur fokusin e tyre, diskursin e përdorur, premtimet e dhëna, alternativat politike që kanë ofruar dhe figurat e liderëve rreth të cilëve është ndërtuar imazhi dhe fuqia e tyre politike. Pikënisje e artikulimeve populiste të të gjitha partive populiste në vendet anëtare të të BE-së është kriza e vitit 2008, efektet e të cilave nuk u kufizuan vetëm në atë vit, por u ndjenë edhe në vitet në vazhdim. Populizmi anti-elitist është dominues në të gjitha partitë që trajtohen në këtë punim. Syriza, Lëvizja Pesë Yjet, Liga Veriore, PiS, Fidesz kanë pasur si strategji fajësimin e establishmentit për gjendjen ekonomike në të cilën u ndodhën vendet e tyre, shpesh herë me të drejtë, pasi që politika të caktuara kanë pasur ndikimin e tyre, por nga ana tjetër edhe duke e ekzagjeruar, sepse kriza nuk prekte vetëm vendet e tyre, por shkonte përtej kufijve të shteteve që ata pretendonin të udhëhiqnin.

Kapitulli III

Ndikimi i diskurit populist në rritjen e euroskepticizmit dhe orientimin e strategjive për zgjerim të BE-së drejt Ballkanit Perëndimor

Në këtë kapitull është analizuar efekti që populizmi ka pasur në rritjen e euroskepticizmit brenda BE-së dhe kulmimi me daljen e një vendi anëtar si Britania nga struktura e saj. Poashtu, është bërë një analizë për mënyrën se si diskursi populist është reflekuar në politikën dhe strategjitë e zgjerimit të BE-së. Ajo që është konstatuar është se rritja e populizmit nuk ka ndikuar thellësisht dhe drejtpërdrejt në politikat e BE-së. Partitë populiste në nivel të BE-së nuk kanë arritur të kenë ndikim të drejtpërdrejt në politikën e zgjerimit. Por, nga ana tjetër, terthorazi kanë ndikuar me modelet e qeverisjeve që kanë aplikuar në vendet e tyre dhe me ndikimin që kanë ushtruar në rajone të caktuara, të cilat kanë marrë dhe kanë përvetësuar praktika qeverisëse të tyre. Nga ana

tjetër edhe afrimi i këtyre partive dhe liderëve të tyre me liderë politikë autoritarë që opreojnë jashtë BE-së ka krijuar konfuzion. Ndikimi krejt minimal i partive populiste në politikat e BE-së ka ndodhur për disa shkaqe. Kjo ka ardhur pjesërisht për shkak të strukturës së funksionimit të BE-së, e cila e vështirëson ndikimin e drejtpërdrejt nga mënyra e vendimarrjes, por edhe sepse partitë populiste në pushtet në fakt kanë dëshmuar që nuk janë aq të zëshme për kauzat e tyre sa janë në opozitë.

Politika e zgjerimit drejt Ballkanit Perëndimor dhe mënyra se si është afektuar nga krizat brenda BE-së është e përfshirë në këtë kapitull, duke u analizuar ajo se si Bashkimi Evropian ndër vite është përpjekur të hedh ide për të krijuar modalitete të reja në mënyrë që ta mbajë Ballkanin Perëndimor të lidhur me Bashkimin Evropian dhe nga stërzgjatja e procesit të integritimit, të mos rritet sentimentimi anti-BE në këtë rajon. Ideja për integrim ekonomik dhe pastaj në një faze tjetër për integrim politik është një prej modaliteteve të propozuara. Pastaj, për shkak të ndërlidhshmërisë së çështjeve që duhen zgjidhur mes vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor është konsideruar mundësia që integrimi i këtij rajoni të bëhet si i tillë në bllok siç ka ndodhur me vendet e Evropës Lindore.

Kapitulli IV

Diskursi populist në skenën politike kosovare

Ky kapitull analizon trendin populist në vendet e Ballkanit Perëndimor. Vendet e Ballkanit Perëndimor janë veçanërisht të ndjeshme ndaj kësaj tendence globale, e cila po rritet nga teknologjitë e reja të komunikimit, sepse përfaqësuesit e tyre politikë kanë prirje për retorikë populiste, mbështetje për praktikat autoritare dhe preferencë për zgjidhje të paqëndrueshme gjatë formulimit të politikave publike. Populizmi është përhapur në mbarë botën, duke u shfaqur në kombët autoritare, demokracitë e përparuara dhe shoqëritë në tranzicion. Trendi autoritar që ka ndodhur në Ballkanin Perëndimor gjatë vitëve të fundit, shërben si konteksti kryesor për studimin e populizmit. Fillimisht kapitulli vë analizën mbi diskursin populist që padyshim është mjaft i përhapur edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor si Serbi, Maqedoni, Bosna-Hercegovina si dhe në Shqipëri, si dhe analizon liderët të cilët konsiderohen si populist në këto vende. Pjesa tjetër e kapitullit vë fokusin në përhapjen e populizmit në Kosovë, analizohen liderët politik, dhe strategjitë populiste të përdorura nga këta të fundit. Kapitulli thekson populizmin e Lëvizjes

Vetëvendosje, e cila konsiderohet padyshim si partia që ka përdorur një diskurs populist të ashpër qysh prej mënyrës që është krijuar, ka vepruar dhe ka arritur që të jetë në pushtet.

PËRFUNDIME

Kriza financiare e vitit 2008 dhe masat shtrënguese që u ndërmorrën nga disa prej vendeve anëtare të BE-së në kuadër të marrëveshjeve për tejkalimin e krizës shërbyen si trampolinë për rritje elektorale të disa prej partive politike populiste në Evropë. Janë disa parti populiste në Evropë me të cilën identifikohet dekada e fundit, si Fronti Kombëtar në Francë, Liga Veriore dhe Lëvizja Pesë Yjet në Itali, Syriza në Greqi, PiS në Poloni, Fidesz në Hungari. Kur bëhet një analizë e të gjitha këtyre partive, arrihet në konkluzionin se kauzat e tyre janë pothuajse identike. Fronti Kombëtar me Marine Le Pen në krye në fushatën e vitit 2012, zgjedhje që i dhanë rritjen më të madhe elektorale, premtoi që do të kufizonte numrin e emigrantëve të paligjshëm, se do të fokusohet tek identiteti kombëtar, proteksionizmi ekonomik, rinacionalizimi i politikës bujqësore. Liga Veriore me Mateo Salvinin gjetën armikun e radhës që nuk ishte Roma, por Bashkimi Evropian dhe u përqëndruan në premtime për deportimin e qindra mijëra emigrantëve. Lëvizja Pesë Yjet, duke shfrytëzuar komunikimin e drejtpërdrejt me qytetarët dhe duke iu dhënë mundësinë atyre që përmes një platforme të kenë rolin e tyre në propozime legjislative, si dhe duke evidentuar sovranitetin e humbur arriti gjithashtu të ketë një kapërcim elektorale që e solli në pushtet në vitin 2018. Syriza shfrytëzoi poashtu krizën e borxhit sovran dhe rrjedhojat e marrëveshjeve të nënshkruara me BE-në dhe FMN-në, për t'iu paraqitur elektoratit si alternativa që do t'i rinegocionte ato marrëveshje dhe në pushtet përfundoi duke nënshkruar një tjetër marrëveshje. Fidesz ndërkohë në emër të krizave të njëpasnjëshme arriti katër mandate në pushtet, duke shfrytëzuar emigracionin, pandeminë, luftën në Ukrainë si momentume për të kanalizuar frikën e hungarezëve tek platforma e saj. Me gjithë rritjen e populizmit, analizat tregojnë që nuk ka pasur ndikim në politikat e BE-së dhe aq më tepër në politikën e zgjerimit. Populistët në pushtet në vendet anëtare të BE-së si Italia dhe Hungaria kanë vazhduar ta shprehin mbështetjen për zgjerimin për integrimin e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Ndërkohë, edhe në

rajonin e Ballkanit Perëndimor populistët kanë shënuar rritje dhe partitë e të gjitha taborreve ideologjike, qoftë si diskurs e qoftë si veprime në kuadër të politikave kanë përdorur populizmin.